

MUNIR RESO

DISA ÇËSHTJE TË GJUHËS LETRARE KOMBËTARE SHQIPE DHE TË NORMËS SË SAJ

Kongresi i drejtshkrimit, që po zhvillon punimet e tij me një përfaqësi dhe pjesëmarrje kaq të gjerë, si një ngjarje me rëndësi të madhe historike për gjuhën dhe kulturën kombëtare, do të kurorëzojë përpjekjet e më se një shekulli që janë bërë për krijimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe të përbashkët e të vetme.

Referati që mbajti shoku Androkli Kostallari, si një sintezë e studimeve të bëra në degë të ndryshme të gjuhësisë sonë, shtroi në një plan të gjerë e të thellë shkencor marksist-leninist, si në anën funksionale ashtu edhe në atë strukturore, problemet dhe rrugët e tyre të zgjidhjes për normalizimin e njësimit e gjuhës letrare kombëtare shqipe, posaçërisht për shprehjen e saj më të gjallë, drejtshkrimin. Njëkohësisht në kumtesat e shumta po rrihen mendimet gjerësisht, në baza të shëndosha shkencore dhe po bëhen propozime e vërejtje të dobishme. Në këtë mënyrë mund të themi me plot gojën se Kongresi po i zhvillon punimet në një nivel të lartë shkencor dhe, me vendimet që do të marrë, do të hapë për gjuhën letrare kombëtare një etapë të re të zhvillimit të saj, atë të kristalizimit të mëtejshëm e të plotë, si gjuhë e përbashkët dhe e vetme për të gjithë shqiptarët, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.

* * *

«Gjuha shqipe, siç ka thënë shoku Enver Hoxha, ka luajtur një rol të madh për edukimin e ndjenjave patriotike të popullit tonë gjatë Rilindjes». Ajo ka qenë vazhdimisht në qendër të lëvizjes sonë kombëtare lidhur ngushtë me detyrat themelore të kësaj lëvizjeje: me çlirimin e vendit, me krijimin e shtetit kombëtar, me zhvillimin dhe përparimin shoqëror.

Rilindësit kanë zhvilluar një veprimtari të dendur e të gjithanshme për gjuhën shqipe në drejtime të ndryshme, në përshtatje me gjendjen dhe kërkesat e kohës, si në aspektin funksional, ashtu dhe në atë strukturor të saj: për shkrimin e shqipes me një alfabet të përbashkët e të vetëm, për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe e përhapjen e saj në popull, për pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe dhe për krijimin e një gjuhe letrare të shkruar, të përbashkët e të

vetme për të gjithë shqiptarët. Për ata gjuha ishte tipari dallues i kombit dhe lëvrimi i gjuhës ishte mjeti më i rëndësishëm i ruajtjes së kombit.

Dhe ne sot kemi gjuhën e vetme e të përbashkët letrare kombëtare, realizimin e ëndërrës së zjarhtë e të përpjekjeve të parreshtura të rilindësve tanë të ndritur.

Si dhe pse erdhëm në këtë Kongres, kush na e dikton aktin e tij?

Gjuhësia shqiptare, si gjithë shkencat e tjera albanologjike, me kujdesin e veçantë të partisë e të pushtetit popullor, e udhëhequr në punën e saj kërkimore nga teoria marksiste-leniniste, ka përpunuar mjaft probleme të rëndësishme. Duke ndjekur një politikë gjuhësore të drejtë, në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit mbi kombin dhe gjuhën kombëtare, ka përpunuar çështje lidhur me gjuhën letrare kombëtare shqipe. Një nga çështjet më kryesore dhe më urgjente, që është shprehje e drejtpërdrejtë e normalizimit, e njësimimit të gjuhës letrare kombëtare dhe për të cilën gjuhësia jonë ka punuar frontalisht, është vendosja, saktësimi dhe njësimi i rregullave të drejtshkrimit.

Me Kongresin e drejtshkrimit të shqipes, ne i përgjigjemi kërkesave, tashmë të shkruara si nga realiteti gjuhësor i shqipes së sotme, ashtu edhe nga realiteti shoqëror i vendit tonë. Pra jemi përpara një domosdoshmërie që na ka nxjerrë koha. Siç na mëson teoria marksiste-leniniste, gjuha është një mjet shumë i rëndësishëm i kumtimit, i marrëdhënjeve midis njerëzve. Ajo, si një fenomen shoqëror, është e lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me historinë e shoqërisë, është e lidhur drejtpërdrejt me çdo veprimtari të njeriut. Gjuha zhvillohet bashkë me zhvillimin e shoqërisë. Gjuha me ligjet e saj të zhvillimit mund të kuptohen vetëm atëhere kur studjohen në lidhje të ngushtë me historinë e popullit, që është krijuesi dhe bartësi i saj. Momente të caktuara të historisë së popullit lënë gjurma në procesin e zhvillimit të gjuhës, pra ajo është një kategori që ndryshon historikisht d.m.th. pëson ndikimin e shoqërisë.

Lidhur me këto K. Marksi dhe F. Engelsi kanë shkruar: «Koncentrimi i dialekteve në gjuhën unike, të vetme kombëtare, të kushtëzuar nga koncentrimi ekonomik dhe politik» (K. Marksi, F. Engels, Veprat, vëll. IV, bot. rus. f. 414).

V. I. Lenini, duke shtjelluar më tej këtë tezë, ka shkruar: «Në të gjithë botën epoka e fitores përfundimtare të kapitalizmit mbi feudalizmin ka qenë e lidhur me lëvizjen kombëtare. Baza ekonomike e këtyre lëvizjeve është kjo: për fitoren e plotë të prodhimit të mallrave, është e domosdoshme fitorja e tregut të brendshëm nga borgjezia, është i domosdoshëm bashkimi i territoreve me popullsi që flet të njëjtën gjuhë, duke hequr çdo pengesë për zhvillimin e kësaj gjuhe dhe për ngulitjen e saj në letërsi...».

Dhe më poshtë vazhdon: «Uniteti dhe zhvillimi pa pengesa i kësaj gjuhe është një nga kushtet shumë të rëndësishme të qarkullimit tregëtar me të vërtetë të lirë e të gjerë që i përshtatet kapitalizmit të sotëm» etj... (Vepra, vëll. I, botim 3, rus., f. 74).

Në kushte e rrethana të veçanta e shumë të vështira kaloi lëvizja jonë kombëtare, Rilindja. Procesi i formimit të gjuhës kombë-

tare me të gjitha format e ekzistencës së saj, nën sundimin e egër otoman, nuk pati kushte të favorshme, si i kanë pasur shumë vende të tjera.

Gjuha amtare nuk lejohej të shkruhej e të përdorej lirisht në sfera të ndryshme të veprimtarisë praktike shoqërore, nuk kishte një shtet kombëtar, s'kishte një qendër të përbashkët politike, administrative, ekonomike, shoqërore e kulturore. Edhe pas shpalljes së pavarësisë kombëtare dhe krijimit të shtetit shqiptar, nën regjimin obskurantist e të prapambetur të feudoborgjezisë, me gjithë se në kushtet e mësimit dhe shkrimit të lirë të gjuhës shqipe në veprimtarinë praktike shoqërore, me gjithë përpjekjet e punës së njerëzve përparimtarë e patriotë, zhvillimi i gjuhës letrare të përbashkët nuk ishte në shkallën e duhur, nuk pati kushte të favorshme zhvillimi, madje nxiteshin dhe ushqeheshin në forma të ndryshme edhe prirjet e «separatizmit» e të «provincializmit» gjuhësor. Tërë këto kanë ndikuar mbi zhvillimin e gjuhës kombëtare në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në formën e saj të shkruar, të cilën çlirimi i vendit dhe vendosja e pushtetit popullor e gjeti në dy variante dhe me luhatje të shumta.

Kultura kombëtare, që kërkon unitetin kombëtar dhe kuptimin reciprok nga të gjithë anëtarët e shoqërisë së re, nuk mund të ruajë praktikën gjuhësore të shumë mjeteve dhe formave të kumtimit, copëzimin dialektor.

Transformimet e thella e të papara politike, ekonomike, shoqërore e kulturore që u bënë në vendin tonë gjatë këtyre tri dekadave të pushtetit popullor, krijuan kushtet e nevojshme dhe shumë të favorshme, si asnjëherë tjetër, jo vetëm për konsolidimin e mëtejshëm e të fuqishëm të kombit mbi baza krejt të reja, për zhvillimin e gjuhës kombëtare, por edhe për kristalizimin e formës së saj letrare, veçanërisht të shkruar në një variant të vetëm e të përbashkët.

Këto që thamë në aspektin teorik gjuhësor shpjegohen në këtë mënyrë: funksionet shoqërore të gjuhës nuk janë diçka të jashtme lidhur me strukturën, me lidhjet sistimore, me ligjet e zhvillimit të saj.

Funksionet shoqërore të gjuhës ndikojnë aktivisht në strukturën, përcaktojnë në një shkallë të rëndësishme drejtimin e zhvillimit të saj.

Natyra e ndryshimeve gjuhësore është e dyanshme: nga njëra anë, gjuha zhvillohet sipas ligjeve të saj të brendshme, në të cilat ekzistojnë mundësitë e ndryshimit në këtë apo atë drejtim; nga ana tjetër nuk realizohen të gjitha ndryshimet e mundshme, sepse ato përcaktohen edhe nga faktorët shoqërorë.

Faktori që ka shpurrë në shkallën e zhvillimit të sotëm strukturor të gjuhës sonë letrare kombëtare dhe në aktin që po ndërmarrim për vendosjen e rregullave të njësuara të drejtshkrimit, është rëndësia shoqërore, që merr gjuha letrare kombëtare e kësaj periudhe. Roli dhe rëndësia e saj shoqërore është zgjeruar shumë dhe afrohet gjithnjë e më tepër me gjuhën e përgjithshme popullore. Sa më i thellë të jetë procesi i zhvillimit shoqëror, aq më efektive dhe më të mëdha bëhen roli dhe rëndësia shoqërore e gjuhës. Socializmi e ka rritur në

shkallë të paparë këtë rëndësi dhe kërkon si domosdoshmëri objektive normalizimin, njësimin e mjetit të kumtimit. Pra faktorët funksionalë (të jashtëm) dhe strukturorë (të brendshëm) ngjishen, mpliksen në mënyrë të ndërlikuar në procesin e formimit dhe zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare.

Gjuha letrare zë një vend të rëndësishëm në sistemin e formave të ekzistencës së gjuhës kombëtare dhe në etapat e para të formimit të saj shërben në variantin e shkruar në sferat më të rëndësishme të veprimtarisë praktike shoqërore; ajo është shprehje e normës kombëtare të përbashkët, shprehje e formës më të lartë të saj, është lulja e ekzistencës së gjuhës kombëtare, gjuhës së përgjithshme popullore. Gjuha letrare është rezultat i krijimtarisë gjuhësore të të gjithë popullit, me mjeshtërit, përpunuesit e dalluar të fjalës në krye; me një fjalë është rezultat i tërë opinionit shoqëror dhe i mjeshtërve të fjalës: personaliteteve shoqërore, shkencëtarëve, shkrimtarëve, specialistëve të gjuhës etj. Roli i përpunuesve të gjuhës varet dhe përcaktohet nga rrethanat dhe kushtet konkrete historike-shoqërore, në të cilat formohet dhe zhvillohet gjuha letrare. Tek ne një rol të dorës së parë ka luajtur dhe luan partia e klasës punëtore, forca udhëheqëse e organizuese e të gjithë jetës së vendit, fjala e të cilës ka shkuar dhe shkon në çdo kënd e në çdo vatër të Shqipërisë.

Në etapat e para të zhvillimit të gjuhës letrare, sfera e përdorimit të saj s'është fort e gjerë, ajo mund të mbizotërojë vetëm në variantin e shkruar, bile mund të mungojë norma e ndërgjegjshme dhe konsekuente, siç ka ndodhur tek ne. Pikërisht për t'i dhënë fund kësaj dhe për të ecur në rrugën e normalizimit dhe kristalizimit të plotë të gjuhës së sotme letrare kombëtare, Kongresi po reh mendimet dhe do të miratojë normën e përpunuar, të vetme e të përgjithshme kombëtare drejtshkrimore si dhe të tjera çështje që përfshin projekti. Sigurisht ky akt me rëndësi të madhe historike, është i nevojshëm, i mbështetur dhe i argumentuar shkencërisht.

Pra, hallka kryesore në zhvillimin e gjuhës kombëtare është procesi i përpunimit të tipit të ri të gjuhës letrare, dhe s'ka asnjë dyshim se tipar i përgjithshëm është *normalizimi i vetëdijshëm i gjuhës letrare*, që bëhet sipas kushteve e rrethanave konkrete kombëtare të çdo gjuhe.

Siç tregon praktika jonë historike gjuhësore si dhe ajo e shumë gjuhëve të tjera të botës formimi dhe zhvillimi i gjuhëve letrare kombëtare nuk është bërë askund pa kodifikimin e sistemit të normave drejtshkrimore, leksikore, gramatikore e ortoepike. Kristalizimi i gjuhës letrare kombëtare, që është shprehje e unitetit kombëtar, nuk mund të arrihet pa normalizimin e vetëdijshëm, pa mendimin teorik të normës dhe të kodifikimit të rregullave të përcaktuara për përdorimin e fjalës.

Pra, norma e përgjithshme kombëtare, e mishëruar në gjuhën letrare, në projekt-drejtskrimin, është rezultat jo vetëm i procesit spontan të zhvillimit të gjuhës, por në një shkallë të rëndësishme i seleksionimit që bëhet gjatë këtij procesi. Normat që janë përcaktuar në rregullat e drejtshkrimit nuk janë kodifikim i thjeshtë i sistemit të veçorive dialektore të ndonjë krahine, këto rregulla e norma janë

rezultat i procesit të gjatë të bashkëveprimit të dialekteve, ku mbështetet gjuha letrare nga njëra anë, dhe i rregullimit nga ana tjetër. Kjo është lidhur me veçoritë e funksioneve shoqërore të gjuhës letrare.

Procesi i formimit të normës letrare të gjuhës kombëtare është aq i ndërlikuar, sa mund të themi se ligjësitë e këtij procesi janë specifike, janë të shumta format e ndryshme të kombinimit të gjuhës së folur në përgjithësi a të ndonjë krahine në veçanti, të traditës së shkruar etj. Për këtë dëshmon realiteti ynë gjuhësor, dëshmojnë gërshtimet dhe bashkëveprimet e elementëve të ndryshëm gjuhësor, si p.sh. lidhur me përdorimin e togut dyzanor *ue* dhe *ua*, me elementët e rotacizmit e jo rotacizmit, me paradigmat, prapashtesat e shumë fenomene të tjera në fushën e leksikut, të fonetikës e të strukturës gramatikore. Përpunimi i normave drejtshkrimore, leksikore, gramatikore është i lidhur ngushtë me zhvillimin e kulturës, masivizimin e arësimit, përvetësimin e teknikës, shkencës, letërsisë, artit etj., prandaj ky proces merr karakter të përgjithshëm popullor, siç u bë me diskutimin e projekt-rregullave të drejtshkrimit dhe siç po e kurorëzon ky Kongres.

Projekt-rregullat e drejtshkrimit të shqipes, të plotësuara e të përforcuara me shtjellimet e propozimet e argumentuara shkencore të kumtesave të shumta pasqyrojnë gjendjen e sotme të gjuhës letrare, prirjet e zhvillimit të saj, traditën e vlefshme, dhe, mbi të gjitha ato mbështeten në gurrën e pashtershme të gjuhës së gjallë të popullit.

Zbatimi i parimit fonetik si themelor, i plotësuar, në radhë të parë, nga parimi morfologjik, i përgjigjet më së miri natyrës së gjuhës shqipe dhe e bën drejtshkrimin që të përvetësohet më lehtë nga masat e gjera punonjëse.

Detyrë e rëndësishme është marrja e masave sa më të përshtatshme dhe efikase për zbatimin e plotë të këtyre rregullave, para ortologjisë dalin mjaft detyra në drejtim të ngritjes së kulturës gjuhësore në masat e gjera punonjëse, në radhë të parë në shkolla.

Nga ana tjetër, duke qenë se gjuha është në zhvillim të vazhdueshëm, gjuhësia jonë jo vetëm do të thellohet më tej në problemet e ndërmarra, por do të realizojë edhe mjaft studime të tjera në drejtim të gjuhës së sotme letrare kombëtare. Megjithëse drejtshkrimi brenda caqeve të veta ndërthen të tri pjesët përbërëse të sistemit gjuhësor, mbetet detyrë studimi i mëtejshëm dhe përcaktimi i normës leksikore, morfologjike, sintaksore dhe ortoipeike.

Duke mbështetur plotësisht parimet dhe kriteret mbi bazën e të cilave po kryejmë këtë akt të madh historik, vendosjen e normës sa më të njësuar të drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare kombëtare do të japim një kontribut të madh në procesin e kristalizimit përfundimtar të saj, në zhvillimin e kulturës sonë kombëtare.

